



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Ekstra 56

Korrik

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.25, datë 24.1.2007	Për disa shtesa në vendimin nr.535, datë 4.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, të Institutit të Studimit të Tokave dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave” 3
Vendim i KM nr.38, datë 24.1.2007	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z.Fatos Kongoli 3
Vendim i KM nr.46, datë 31.1.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.565, datë 9.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike” 4
Vendim i KM nr.50, datë 7.2.2007	Për lirim dhe emërim në detyrë të prefektit të qarkut të Shkodrës 4
Vendim i KM nr.53, datë 7.2.2007	Për emërim në detyrë 5
Vendim i KM nr.54, datë 31.1.2007	Për ngritjen dhe funksionimin e njësisë <i>ad hoc</i> , për shqyrtimin e dosjeve të prapambetura të Komisionit Qendror të Statusit të Dëshmorëve të Atdheut, si dhe për ngarkimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për ndjekjen dhe zbatimin e plotësimit të kriterëve, për përfitimin e shpërblimit nga familjarët e dëshmorëve 6
Vendim i KM nr.75, datë 21.2.2007	Për dhënie ndihme financiare familjeve të Besnik Haki Hidrit dhe Lekë Fran Çokut, ish-punonjës të Shërbimit Informativ të Shtetit, të vrarë në krye të detyrës 7
Vendim i KM nr.79, datë 17.2.2007	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të disa mjediseve të “Alba Film Studio” sh.a., nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve te Ministria e Brendshme 8

Vendim i KM nr.105, datë 2.3.2007	Për lirim nga detyra	12
Vendim i KM nr.113, datë 17.2.2007	Për organizimin, funksionimin, përbërjen dhe përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Komitetit Ndërsektorial, për Mbrojtjen nga Produktet e Duhanit (KNMSHPD)	12
Vendim i KM nr.121, datë 14.3.2007	Për lirim nga detyra	13
Vendim i KM nr.122, datë 14.3.2007	Për dhënie ndihme financiare familjeve të viktimave dhe të mbijetuarve të aksidentit rrugor, në aksin Kir-Dukagjin, më 12.3.2007	13
Vendim i KM nr.140, datë 29.3.2007	Për dhënie fondi për blerje apartamentesh banimi, në ndihmë të familjeve të rrezikuara nga shembja e pallatit në lagjen “Dukas” në bashkinë Patos të qarkut të Fierit	14
Vendim i KM nr.154, datë 21.3.2007	Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtimin në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2007	15
Vendim i KM nr.159, datë 30.3.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin, në Itali, të z.Bashkim Gazidede	15
Vendim i KM nr.161, datë 30.3.2007	Për lirim dhe emërim në detyrë	16
Vendim i KM nr.178, datë 4.4.2007	Për marrjen e masave për zbatimin e studimit të reformës së kërkimit shkencor, pjesë e rrjetit të instituteve të Akademisë së Shkencave	16
Vendim i KM nr.192, datë 11.4.2007	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.748, datë 9.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e fondit të mallrave rezervë shtetërore”	21
Vendim i KM nr.198, datë 18.4.2007	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z.Bep Jubani ...	21
Vendim i KM nr.214, datë 18.4.2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.703, datë 11.10.2006 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore apo të objekteve të veçuara, që u nënshtrohen privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregtare”	22
Vendim i KM nr. 217, datë 18.4.2007	Për disa ndryshime në vendimin nr.183, datë 28.3.2007 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin, shtypjen dhe emetimin e biletave në transportin rrugor”	23
Vendim i KM nr.219, datë 18.4.2007	Për dhënie ndihme financiare shtetases Pranvera Mehmeti	23

Vendim i KM nr.227, datë 24.4.2007	Për lirim dhe emërim në detyrë	24
Vendim i KM nr.232, datë 25.4.2007	Për një shtesë në vendimin nr.444, datë 5.9.1994 të Këshillit të Ministrave “Për tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudit të veprave të ndërtimit”	24
Vendim i KM nr.236, datë 27.4.2007	Për lirim nga detyra	25
Vendim i KM nr.245, datë 25.4.2007	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të objektit “Truall përreth poliklinikës së shërbimit parësor të lagjeve 1 e 2, Kavajë”, dhe të ndërtesave, që ndodhen në këtë truall, nga Ministria e Shëndetësisë Ministrisë së Drejtësisë	25
Vendim i KM nr.250, datë 27.4.2007	Për ekzekutimin e vendimit nr.7352/03, datë 22.8.2006 të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për çështjen “Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë”	26
Vendim i KM nr.252, datë 4.5.2007	Për emërim në detyrë	26
Vendim i KM nr.256, datë 4.5.2007	Për lirim nga detyra	27
Vendim i KM nr.280, datë 9.5.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e znj. Eva Vrapit, në Itali	27
Vendim i KM nr.288, datë 19.5.2007	Për propozimin për zgjedhjen në detyrë të Avokatit të Prokurimeve	28
Vendim i KM nr.292, datë 16.5.2007	Për dhënie ndihme financiare familjes së nënoficerit Sadik Basha, vrarë në krye të detyrës	28
Vendim i KM nr.300, datë 25.5.2007	Për një shtesë në vendimin nr.352, datë 3.5.1995 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e certifikatave të pronësisë së pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar	29
Vendim i KM nr.309, datë 25.5.2007	Për miratimin e vlerës së aksioneve të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë	29
Vendim i KM nr.310, datë 25.5.2007	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2007, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin, në SHBA, të znj. Zamira Sinoimeri ...	30

VENDIM
Nr.25, datë 24.1.2007

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.535, DATË 4.8.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË
MJEDISEVE TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, TË INSTITUTIT TË STUDIMIT
TË TOKAVE DHE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.535, datë 4.8.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:
 - a) Pas fjalës “...i dytë...” shtohen “... dhe i tretë”.
 - b) Genplanit, që i bashkëlidhet vendimit, i shtohet edhe genplani, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Qendra për Transferimin e Teknologjive Bujqësore për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.38, datë 24.1.2007

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z.FATOS KONGOLI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- Dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z.Fatos Kongoli, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.2.2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.46, datë 31.1.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.565, DATË 9.8.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MBROJTJEN E SHITRESAVE NË NEVOJË, NGA RRITJA E ÇMIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 1 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” dhe të ligjit nr.9465, datë 27.11.2006 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja “c” e pikës 1 e vendimit nr.565, datë 9.8.2006 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) kryefamiljarët, që përfitojnë pension pleqërie, shtetëror, ose që përfitojnë pension pleqërie, fshati, por që janë me banim në qytet dhe nuk kanë anëtarë të familjes, të punësuar në sektorin publik apo të punësuar në subjekte, juridike fizike, e private a të vetëpunësuar në sektorin privat, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.50, datë 7.2.2007

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Zoti Gjovalin Kolombi, prefekt i qarkut të Shkodrës, lirohet nga kjo detyrë.
 2. Zoti Maxhid Cungu emërohet prefekt i qarkut të Shkodrës.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.53, datë 7.2.2007

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin e funksionimit të Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Zoti Nikolin Jaka emërohet zëvendësministër i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.54, datë 31.1.2007

PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E NJËSISË AD HOC, PËR SHQYRTIMIN E DOSJEVE TË PRAPAMBETURA TË KOMISIONIT QENDROR TË STATUSIT TË DËSHMORËVE TË ATDHEUT, SI DHE PËR NGARKIMIN E INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE, PËR NDJEKJEN DHE ZBATIMIN E PLOTËSIMIT TË KRITEREVE, PËR PËRFITIMIN E SHPËRBLIMIT NGA FAMILJARËT E DËSHMORËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8607, datë 27.4.2000 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen dhe funksionimin e njësisë *ad-hoc*, si staf i përkohshëm teknik, për shqyrtimin e, gjithsej, 491 dosjeve, në pritje në Komisionin Qendror të Statusit të Dëshmorëve të Atdheut. Këto dosje duhet të jenë regjistruar deri më datë 31.12.2006.

2. Njësia *ad-hoc* përbëhet nga 5 anëtarë, me profesion juristë, si më poshtë vijon:

a) Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, në Këshillin e Ministrave;

b) Këshilltari ligjor i zëvendëskryeministrit;

c) Një përfaqësues nga Kontrolli i Lartë i Shtetit;

ç) Një përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes, me minimumin 5 vjet përvojë pune si jurist;

d) një përfaqësues nga Ministria e Brendshme, me minimumi 5 vjet përvojë pune si jurist.

3. Ministri i Brendshme dhe Ministri i Mbrojtjes të caktojnë përfaqësues të tyre persona, që, për shkak të funksionit, kanë akses në arkivat e këtyre ministrive, për verifikimin e informacioneve, të të dhënave zyrtare apo provave të paraqitura në dosje, sipas afateve të përcaktuara në mbledhjet e radhës së njësisë.

4. Njësia *ad-hoc*, pasi të ketë përfunduar shqyrtimin, duhet të përgatisë, për çdo dosje, një relacion ligjor, mbështetur vetëm në prova të plota, që provojnë ose rrëzojnë njërin nga ngjarjet e përcaktuara në nenin 2, shkronjat nga “a”-“ë” të ligjit nr.8607, datë 27.4.2000 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar, dhe të drejta të tjera të ligjshme, të lidhura me to. Ky relacion duhet të përmbajë:

a) kërkesën për shpalljen ose njohjen “Dëshmor i Atdheut” apo të drejta të tjera të ligjshme të lidhura me to;

b) Mbështetjen në prova dhe të ligj;

c) Arsyetimin ligjor;

ç) Rekomandimin përfundimtar, për pranimin apo refuzimin e kërkesës.

Çdo anëtar ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për përmbajtjen e këtij relacioni dhe e nënshkruan atë. Anëtarë, që është kundër arsyetimit të shumicës, evidenton, me shkrim, qëndrimin, në mënyrë specifike dhe të argumentuar. Mendimi i pakicës është pjesë e relacionit, që i paraqitet komisionit.

Njësia ad-hoc, brenda 45 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, përfundon detyrën e caktuar.

Kryetari i Komisionit Qendror të Statusit të Dëshmorëve të Atdheut cakton njërin nga anëtarët për ndjekjen e procedurave, për përgatitjen e rendit të ditës, shpërndarjen e tij dhe të materialeve anëtarëve, si dhe për ndjekjen e procesit të nënshkrimit të vendimeve.

Një kopje e vendimeve u dërgohet, sipas ligjit, të interesuarve dhe institucioneve përgjegjëse, për zbatimin e të drejtave civile, nëse ka.

5. Njësia *ad-hoc* e ushtron veprimtarinë në mjediset e kryeministrit, pa kufizim dite dhe orari zyrtar.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes, që, brenda 3 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të dorëzojë, me procesverbal, në protokollin e Kryeministrit 491 dosjet e regjistruara në Komisionin Qendror të Dëshmorëve të Atdheut para datës 31.12.2006. Çdo dosje duhet të shoqërohet me listën e dokumenteve përkatëse.

7. Ngarkohen përfaqësuesi i Ministrit të Mbrojtjes dhe protokollin e Kryeministrit, që, pas përfundimit të shqyrtimit nga Komisioni Qendror i Dëshmorëve të Atdheut të të gjitha dosjeve, të bëjnë dorëzimin, me procesverbal, në arkivin e Ministrit të Mbrojtjes.

8. Veprimtaria e njësive *ad-hoc* përfundon pas shqyrtimit të të gjitha dosjeve të prapambetura dhe pritje në Komisionin Qendror të Statusit të Dëshmorëve të Atdheut.

9. Dispozitat për përgjegjësinë e stafit teknik, të përcaktuara në vendimin nr.151, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, zbatohen nga stafi i përkohshëm, për aq sa ato nuk bien në kundërshtim me këtë vendim.

10. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore, që, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të kryejë verifikimin e dokumenteve të të gjitha dosjeve, që administron ky Institut, për pagesën e familjarëve të Dëshmorëve të Atdheut dhe, në varësi të rezultatit, të kryejë vazhdimin apo ndërprerjen e menjëhershme të kësaj pagese, në përputhje me nenin 6 të ligjit nr.9650, datë 27.11.2006.

11. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, 45 ditë pas afatit të përcaktuar në pikën 10 të këtij vendimi, të vazhdojë pagesën, për të gjithë familjarët, të cilët nga verifikimi i dokumentacionit në dosje, rezultojnë se përmbushin kriteret e nenit 14 të ligjit nr.8607, datë 27.4.2000 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, kërkon njoftim zyrtar nga zyra përgjegjëse e gjendjes civile e vendbanimit të familjarit, për përbërësit aktualë të gjendjes civile të familjarëve. Në varësi të dokumentacionit të lëshuar nga zyra e gjendjes civile, Instituti kryen vazhdimin apo ndalimin e menjëhershëm të pagesës.

Kur zyra e gjendjes civile vëren, sipas regjistrat, se familjari ka transferuar regjistrin në territorin e një njësie tjetër vendore, ai transferon drejtpërdrejt, kërkesën përkatëse në njësine përgjegjëse, duke i përcjellë një kopje të njoftimit të transferimit, sipas regjistrat, edhe ISSH-së. Zyrat e gjendjes civile duhet t'i dërgojnë dokumentet brenda 15 ditëve nga data e mbërritjes së kërkesës.

12. Ngarkohen zëvendëskryeministri, Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave dhe drejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.75, datë 21.2.2007

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE TË BESNIK HAKI HIDRIT DHE
LEKË FRAN ÇOKUT, ISH-PUNONJËS TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT, TË
VRARË NË KRYE TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin e zbatimit e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare, prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, përkatësisht, familjes së Besnik Haki Hidrit dhe familjes së Lekë Fran Çokut, ish-punonjës të Shërbimit Informativ të Shtetit, të vrarë në krye të detyrës.

2. Ky fond përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.79, datë 17.2.2007

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DISA MJEDISEVE TË “ALBA
FILM STUDIO” SHA, NGA MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE
SPORTEVE TE MINISTRIA E BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të disa mjediseve të “Alba Film Studio” sh.a., nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve te Ministria e Brendshme (Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Drejtorisë së PMNSH-së), sipas formularit dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ministrisë së Brendshme (Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Drejtorisë së PMNZSH-së) i ndalohej ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë apo t’ua japë në përdorim të tretëve.


3. Ngarkohet Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministri i Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

[illegible]





VENDIM
Nr.105, datë 2.3.2007

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 31.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Gjergj Bojaxhi, zëvendësministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.113, datë 17.2.2007

PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, PËRBËRJEN DHE PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KOMITETIT NDËRSEKTORIAL, PËR MBROJTJEN NGA PRODUKTET E DUHANIT (KNMSHPD)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komitetit Ndërsektorial për Mbrojtjen nga Produktet e Duhanit (KNMSHPD), me kryetar Ministrin e Shëndetësisë, dhe me këtë përbërje:

- | | |
|---|---------|
| - Zëvendësministri i Financave | anëtar; |
| - Zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës | anëtar; |
| - Zëvendësministri i Brendshëm | anëtar; |
| - Zëvendësministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | anëtar; |
| - Kryetari i Këshillit Kombëtar i Radios dhe Televizionit Publik Shqiptar | anëtar; |
| - Drejtori i Institutit të Shëndetit Publik | anëtar; |
| - Kryeinspektori Sanitar Shtetëror | anëtar; |
| - Drejtori i Policisë Bashkiake, Tiranë | anëtar; |

Funksionet e sekretarit të KNMSHPD-së kryhen nga Drejtori i Institutit të Shëndetit Publik.

2. KNMSHPD-ja përgjigjet për detyrat e ngarkuara në nenet 4 dhe 18 të ligjit nr.9363, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.

3. KNMSHPD-ja mblidhet jo më pak se 4 herë në vit dhe thirret nga kryetari, i cili, 5 ditë para mbledhjes, u njofton anëtarëve rendin e ditës dhe u dërgon atyre materialet përkatëse.

4. Mbledhjet janë të vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve dhe vendimet merren me shumicë votash. Në rast barazimi të votave “pro” dhe “kundër”, vota e kryetarit është përcaktuese.

5. Anëtarët e KNMSHPD-së, caktojnë, në çdo mbledhje, me shumicë votash, rendin e ditës së mbledhjes së ardheshme.

6. Shpërblimi për pjesëmarrësit, për çdo mbledhje, është 5 000 (pesëmijë) lekë.
 7. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë.
 8. Krahas detyrave të përcaktuara në ligjin në fuqi, KNMSHPD-ja përcakton formën dhe tekstin e mesazheve në çdo njësi pakete apo paketimi të produkteve të duhanit. Përditësimi i tyre bëhet, minimalisht, çdo 2 vjet.
 9. Sekretari i KNMSHPD-së mban procesverbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari.
 10. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.121, datë 14.3.2007

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 31.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z.Armand Teliti, zëvendësministër i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.122, datë 14.3.2007

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE TË VIKTIMAVE DHE TË MBIJETUARVE TË AKSIDENTIT RRUGOR, NË AKSIN KIR-DUKAGJIN, MË 12.3.2007

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, për prefektin e qarkut Shkodër, t’i shtohet fondi prej 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekësh, i cili të përdoret si ndihmë financiare për familjet e viktimave dhe të mbijetuarve të aksidentit rrugor, në aksin Kir-Dukagjin, më 12.3.2007.

2. Familjeve të viktimave t’u jepet shuma 1 080 000 (një milion e tetëdhjetë mijë) lekë për çdo viktimë.

3. Çdo të mbijetuari, për rehabilitimin shëndetësor, t’i jepet shuma 400 000 (katërqind mijë) lekë.

4. Fondi i përgjithshëm prej 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

5. Ngarkohet prefekti i qarkut Shkodër, që, në bazë të dokumenteve dhe procedurave ligjore, përfshirë dokumentin e identifikimit dhe dokumentet mjekësore, t'u shpërndajë përfaqësuesve të familjeve të viktimave dhe të mbijetuarve shumat e përcaktuara në pikat 2 e 3 të vendimit, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Ngarkohet Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm dhe prefekti i qarkut të Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.140, datë 29.3.2007

PËR DHËNIE FONDI PËR BLERJE APARTAMETESH BANIMI, NË NDIHMË TË FAMILJEVE TË RREZIKUARA NGA SHEMBJA E PALLATIT NË LAGJEN “DUKAS” NË BASHKINË PATOS TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2007”, dhe të neneve 31 e 32/a të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkisë Patos të qarkut të Fierit, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, t'i jepet një fond shtesë prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për familjet, që banojnë në pallatin në lagjen “Dukas”, të kësaj bashkie, i cili rrezikon të shembet.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Emrat e kryefamiljarëve të familjeve, që do të përfitojnë nga ky fond, janë sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Familjet, që përfitojnë nga ky vendim, përpara se të tërheqin shumën përkatëse për blerjen e apartamenteve në tregun e lirë, detyrohen të bëjnë kalimin e pronësisë së banesës së vjetër dhe të truallit nën sipërfaqen e ndërtimit, në pronësi të bashkisë së Patosit.

5. Ngarkohet bashkia e Patosit, që, pas lirimit të plotë të pallatit nga familjarët, në përputhje me rregullat, financiare dhe teknike, të marrë masa për prishjen e ndërtesës.

6. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, prefekti i qarkut të Fierit dhe bashkia e Patosit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTAT E KRYEFAMILJARËVE TË FAMILJEVE, BANORË NË PALLATIN E RREZIKUT
NGA SHEMBJA NË LAGJEN “DUKAS” TË BASHKISË PATOS, QARKU FIER

Nr.	Emër	Atësia	Mbiemri	Sipërfaqja që disponon	Fondi që i akordohet në 000/lekë
1.	Ektor	Aris	Metaj	74 m ²	1 250
2.	Vasil	Koli	Golloshi	74 m ²	1 250
3.	Rauf	Riza	Hoxhaj	74 m ²	1 250
4.	Xhevat	Kodhel	Bregu	74 m ²	1 250
5.	Haxhi	Rrapo	Nuhaj	74 m ²	1 250
6.	Faslli	Rexhep	Shpata	74 m ²	1 250
7.	Sile	Sotir	Marko	74 m ²	1 250
8.	Sulo	Mete	Murataj	74 m ²	1 250
				Totali	10 000

VENDIM
Nr.154, datë 21.3.2007

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PËRGJITHSHËM ANALITIK TË
PROJEKTAKTEVE, QË DO TË PARAQITEN PËR SHQYRTIMIN NË KËSHILLIN E
MINISTRAVE, GJATË VITIT 2007**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2007, sipas tabelave, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.159, datë 30.3.2007

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KURIMIN,
NË ITALI, TË Z.BASHKIM GAZIDEDË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 8 e 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006, “Për buxhetin e shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, në programin “Administrim, planifikim, menaxhim”, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 4 000 000 (katër milionë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin, në Itali, të z.Bashkim Gazidede.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. PAGESA të kryhet pas paraqitjes së faturave përkatëse.

4. Vendimi nr.796, datë 27.11.2006 i Këshillit të Ministrave shfuqizohet.

5. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.161, datë 30.3.2007

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 9 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z.Bajram Ibraj, drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, të lirohet nga kjo detyrë.

2. Z.Ahmet Preçi të emërohet drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

3. Ngarkohet Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.178, datë 4.4.2007

**PËR MARRJEN E MASAVE PËR ZBATIMIN E STUDIMIT TË REFORMËS SË
KËRKIMIT SHKENCOR, PJESE E RRJETITI TË INSTITUTEVE TË AKADEMISË SË
SHKENCAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës të marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e studimit të reformës së kërkimit shkencor, sipas tabelës/aneksit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Arsimit dhe Shkencës të paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave paketën, e plotë e të hollësishme, për riorganizimin institucional të institucioneve të kërkimit, që kanë qenë në varësi të Akademisë së Shkencave, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Akademia e Shkencave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA ANEKSE 1
MATRICA E VLERËSIMIT TË INSTITUTEVE KËRKIMORE TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE PROPOZIMET PËR
RIORGANIZIMIN INSTITUCIONAL TË TYRE

INSTITUTI	PROPOZIMET KONKRETE PËR REFORMIMIN E INSTITUCIONIT KËRKIMOR	PROPOZIMET KONKRETE PËR INSTITUCIONIN E RI OSE ATË PRITËS
1. INSTITUTI I GJUHËSISË DHE LETËRSISË	Mbi bazën e këtyre instituteve ngrihet Qendra Ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike (QNSA)	Misioni i QNSA do të jetë kërkimi shkencor në fushat albanologjike dhe ndihmesa në përgatitjen e studentëve, veçanërisht në nivelet e magjistraturës dhe doktoratës. Personeli shkencor i Qendrës do të ketë së paku 30 % të kohës së punës veprimtari mësimore në universitet. Pjesa tjetër e ngarkesës do të jetë kërkim shkencor.
2. INSTITUTI I HISTORISË		QNSA organizohet në departamente ose institute pasi të jenë ristudiuar fushat e kërkimit shkencor të Qendrës. Mbi këtë bazë do të ndërtohet organika dhe do të integrohet i gjithë personeli shkencor dhe një pjesë e atij ndihmës të instituteve ekzistuese. Organike e QNSA miratohet nga MASH-i.
3. QENDRA E ENCIKLOPESISË SHQIPTARE		
4. INSTITUTI I KULTURËS POPULLORE		
5. QENDRA E STUDIMIT TË ARTEVE		
6. INSTITUTI I ARKEOLOGJISË		QNSA do të gëzojë autonominë në përputhje me ligjin e shkencës dhe zhvillimit të teknologjisë dhe ligjin e arsimit të lartë, derisa të hartohet dhe miratohet ligji i ri për arsimin e lartë. QNSA do të ketë varësi institucionale nga Ministria e Arsimit dhe shkencës, e njëjtë si varësia që kanë universitetet nga MASH-i
7. INSTITUTI I EKONOMISË	Instituti shkrihet. Personeli shkencor të kalojë pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës	Fakulteti i Ekonomisë integron personelin shkencor në përputhje me nevojat që ka për personel mësimor-shkencor.
8. INSTITUTI I SIZMOLOGJISË (IS)	Integrohet në Qendrën Kërkimore Universitare të Gjeoshkencave (QKGJ) pranë Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT).	Qendra Kërkimore Universitare e Gjeoshkencave (QKGJ) ngrihet pranë UPT dhe përbëhet nga departamentet e mëposhtme:

		- Departamenti i Gjologjisë - Departamenti i Gjeofizikës - Laborator i Gjeoteknikës - Laborator i Gjeoinformacionit - Arkivi Qendror i Gjeoinformacionit Ky institut do të jetë baza e DEPT të gjeofizikës të QKGJ. Personeli i instituti integrohet përmes konkursit në QKGJ, mbi bazë e organikës së re të propozuar nga universiteti dhe të miratuar nga MASH-i
9. INSTITUTI I HIDROMETEOROLOGJISË	Integrohet në Qendrën Kërkimore Universitare të Ujit, Energjisë dhe Mjedisit (QKUEM) pranë UPT.	QKUEM do të ketë departamentet e mëposhtme: - Departamenti i energjisë dhe ujit formohet mbi bazën e DEPT të hidrologjisë të ASH, sektorit të hidrologjisë (Shërbimi Gjeologjik dhe Qendrës së Kërkimeve Hidraulike të ASH. - Departamenti i mjedisit formohet mbi bazën e dept. të mjedisit të këtij instituti dhe sektorit të gjeomjedisit (Shërbimi Gjeologjik) - Departamenti e klimës formohet mbi bazën e Departamentit në metrologjisë. Personeli i institutit integrohet përmes konkursit në QKUEM, mbi bazën e organikës së re të propozuar nga universiteti dhe të miratuar nga MASH-i.
10. QENDRA E KËRKIMEVE HIDRAULIKE	Integrohet në Qendrën Kërkimore Universitare të Ujit, Energjisë dhe Mjedisit (QKUEM) pranë UPT.	Bëhet pjesë e dept. të energjisë dhe ujit e QKUEM (shih më lart). Personeli i Qendrës integrohet, përmes konkursit, në QKUEM, mbi bazën e organikës së re të propozuar nga universiteti dhe të miratuar nga MASH-i

11. QENDRA E STUDIMEVE GJEORAFIKE (QSGJ)	Bashkohet me dept. gjeografisë të Universitetit të Tiranës (UT)	Bashkohen me dep. e Gjeografisë pranë UT. Personeli integrohet përmes konkursit në dept. gjeografisë të UT, mbi bazën e organikës së re të propozuar nga universiteti dhe të miratuar nga MASH-i
12. INSTITUTI I KËRKIMEVE BIOLOGJIKE (IKB)	- Instituti shkrihet. Pjesa e Institutit që lidhet me kërkimin në biologji molekulare dhe bioteknologji integrohet në strukturat që do të ngrihen në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT). Pjesa e instituti që bën kërkim në fushën e florës mund të integrohet në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës (UT). - Herbari Kombëtar të marrë statusin si njësi e shërbimit universitar, pranë Muzeut të Shkencave Natyrore të Fakultetit Shkencave Natyrore të UT.	Në UBT krijohet një fakultet i ri që mbulon fushat e bioteknologjisë, mikrobiologjisë e teknologjisë ushqimore, si dhe të cilësisë së ushqimit të njeriut, në të cilin, përveç IKB, përfshihen edhe disa departamente ekzistuese të këtij universiteti në fushat e lartpërmendura. Fakulteti mund të quhet Fakulteti i Bioteknologjisë & Ushqimit. Personeli i IKB integrohet përmes konkursit në fakultetin e ri të UBT dhe në Fakultetin. Shkencave të UT, mbi bazën e organikës së miratuar nga shkollat e larta dhe MASH-i.
13. INSTITUTI FIZIKËS BËRTHAMORE (IFB)	Instituti riorganizohet në formën e Autoritetit Kombëtar Atomik në varësi të MASH-it	Në funksion të këtij organizimi, përbërje të Autoritetit Kombëtare Atomik mbeten vetëm njësitë që kryejnë detyra/funksione të tilla. Të tilla janë departamenti i mbrojtjes radiologjike humane dhe mjedisit dhe një pjesë e departamentit të teknologjive. Njësitë e tjera duhet të integrohen në departamentin fizikës të Fakultetit të Shkencave të Universitetit të Tiranës.

VENDIM
Nr.192, datë 11.4.2007

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.748, DATË 9.12.2005 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E FONDIT TË MALLRAVE REZERVË SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, shkronja “ë”, e 8, shkronja “h”, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.748, datë 9.12.2005 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

1. Në lidhjen nr.1, artikulli miell, sasia “800 tonë” të bëhet “600 tonë”.
 2. Në pikën 2, të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:
“Fondi limit për prokurimin e artikullit miell të jetë në funksion të sasisë dhe të çmimit mesatar, që do të rezultojë nga testimi, privat dhe zyrtar, i tregut.”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.198, datë 18.4.2007

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. BEP JUBANI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Bep Jubani në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, plus këtë shtesë të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.5.2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.214, datë 18.4.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.703, DATË 11.10.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E VLERËSIMIT DHE TË SHITJES SË TROJEVE TË NDËRMARRJEVE SHTETËRORE APO TË OBJEKTEVE TË VEÇUARA, QË U NËNSHTROHEN PRIVATIZIMIT OSE TRANSFORMIMIT TË TYRE NË SHOQËRI TREGTRE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.703, datë 11.10.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në kapitullin IV të bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i dytë, i shkronjës “a” të pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Vërtetimin se subjekti kërkues e ka paguar qiranë e truallit deri në çastin e pagesës së vlerës së plotë të truallit, sipas autorizimit të lëshuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave.”.

b) Në fund të pikës 5 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike kryeson komisionin e verifikimit të sipërfaqeve të truallit të objekteve të privatizuara, që kërkojnë saktësim.”.

2. Në kapitullin e V “Të përgjithshme”, pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Të gjitha dosjet me kërkesa për vlerësim truall të objekteve të privatizuara, të dërguara nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj në rrethe, pranë organeve të qeverisjes vendore, sipas vendimit nr.169, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave, për të cilat nuk është dërguar vlerësimi i truallit në ish-Agjencinë Kombëtare të Privatizimit, degët e saj në rrethe dhe Ministrinë e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, deri një ditë para hyrjes në fuqi të vendimit nr.703, datë 11.10.2006, do të kthehen në Ministrinë e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, për të filluar procedurat nga e para, sipas kërkesave të këtij vendimi.”.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 217, datë 18.4.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.183, DATË 28.3.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN, SHTYPJEN DHE EMETIMIN E BILETAVE NË
TRANSPORTIN RRUGOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 36 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.183, datë 28.3.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Pajisja me bileta tatimore të udhëtarëve të kryhet për të gjitha llojet e shërbimit të transportit të udhëtarëve në transportin rrugor, përjashtuar rastet kur mjetet e tipit 4+1 janë pajisur me taksimetër, me tregues fiskal.”.

2. Në fjalinë e fundit, ku përcaktohet hyrja në fuqi e vendimit, fjalët “... 1 korrik 2007.” zëvendësohen me “... 1 qershor 2007.”.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 qershor 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.219, datë 18.4.2007

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE SHTETASES PRANVERA MEHMETI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të viti 2007”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, grupi 25, titulli 10430, kap.1, artikulli 606 “Transferta të brendshme”, t’i shtohet fondi prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh, për dhënie ndihme të menjëhershme financiare shtetases Pranvera Mehmeti.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.227, datë 24.4.2007

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Mimoza Hasekiu, prefekte e qarkut të Elbasanit, lirohet nga kjo detyrë.
 2. Z.Rezart Kovaçi emërohet prefekt i qarkut të Elbasanit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.232, datë 25.4.2007

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.444, DATË 5.9.1994 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR TARIFAT E STUDIMIT, PROJEKTIMIT, DREJTIMIT DHE KOLAUDIMIT TË
VEPRAVE TË NDËRTIMIT”

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimi nr.444, datë 5.9.1994 të Këshillit të Ministrave, në shtojcën, që i bashkëlidhet vendimit, në shkronjën “A”, në fund të pjesës “Hartimi i projekteve dhe preventivave”, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Në rastin e ndërtimeve të objekteve kulturore dhe të artit skenik, me rëndësi të veçantë për kulturën kombëtare dhe për të cilat kërkohen njohuri të posaçme, me urdhër të ministrit, që mbulon fushën e kulturës, koeficienti i hartimit të projekteve dhe preventivit mund të rritet deri në 8 për qind.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.236, datë 27.4.2007

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z.Gjergj Lezhja, zëvendësministër i Brendshëm, lirohet nga kjo detyrë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.245, datë 25.4.2007

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË OBJEKTIT “TRUALL
PËRRETH POLIKLINIKËS SË SHËRBIMIT PARËSOR TË LAGJEVE 1 E 2, KAVAJË”, DHE
TË NDËRTESAVE, QË NDODHEN NË KËTË TRUALL, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË
MINISTRISË SË DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të objektit “Truall përreth poliklinikës së shërbimit parësor të lagjeve 1 e 2, Kavajë”, me sipërfaqe 14 500 m², të ndërtesës karabina, me sipërfaqe 1 015,5 m², me dy kate dhe konstruksion tulle, dhe të ndërtesës karabina, me sipërfaqe 255,18 m², me tri kate dhe konstruksion tulle, nga Ministria e Shëndetësisë, Ministrisë së Drejtësisë, sipas skicës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për ndërtimin e Institutit të Vuajtjes së Dënimit për të Miturit, donacion i Komisionit European për Drejtësinë.

2.Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Shëndetësisë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.250, datë 27.4.2007

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT NR.7352/03, DATË 22.8.2006 TË GJYKATËS
EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, PËR ÇËSHTJEN “BESHIRI DHE TË TJERË
KUNDËR SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të nenit 46 të konventës europiane për të drejtat e njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit nr.7352/03 të datës 22.8.2006 të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për çështjen “Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, në vlerën 126 000 (njëqind e njëzet e gjashtë mijë) euro.

2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 12 maj 2007.

3. Shuma prej 126 000 eurosh të depozitohet në njerën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve “Beshiri dhe të tjerë”, dhe të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e çeljes së llogarisë.

4. Shuma e depozituar sipas pikës 3 të këtij vendimi, e cila do t’i paguhet ankuesve “Beshiri dhe të tjerë”, të përballohet nga Ministria e Financave, nga fondi i shpronësimeve, në llogarinë speciale, përkundrejt paraqitjes të së gjithë dokumentacionit ligjor, të nevojshëm, për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.252, datë 4.5.2007

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z.Genti Strazimiri emërohet zëvendësministër i Brendshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.256, datë 4.5.2007

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z.Vladimir Kristo, zëvendësministër i Drejtësisë, lirohet nga kjo detyrë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.280, datë 9.5.2007

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KURIMIN E ZNJ. EVA VRAPI, NË ITALI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 2 800 000 (dy milionë e tetëqind mijë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin e znj. Eva Vrapit, në Itali.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Pagesa të bëhet pas paraqitjes së faturave origjinale të institucionit të kurimit.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.288, datë 19.5.2007

PËR PROPOZIMIN PËR ZGJEDHJEN NË DETYRË TË AVOKATIT TË PROKURIMEVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 15 e 16 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për zgjedhjen e z.Edi Spaho në detyrën e Avokatit të Prokurimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.292, datë 16.5.2007

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË NËNOFICERIT SADIK BASHA,
VRARË NË KRYE TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 28 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e një ndihme financiare, prej 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, familjes të së ndjerit nënoficerit Sadik Basha, vrarë në krye të detyrës.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.300, datë 25.5.2007

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.352, DATË 3.5.1995 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E CERTIFIKATAVE TË PRONËSISË SË PASURIVE TË
PALUAJTSHME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 56 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 1/a të vendimit nr.352, datë 3.5.1995 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 1/b me këtë përmbajtje:

“1/b. Certifikata e vërtetimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme përmban elemente sigurie, një numër serial gjashtëshifror, unik për të gjithë Republikën e Shqipërisë dhe mbi të aplikohet vula metalike (e thatë).

- Forma dhe modeli i certifikatës së vërtetimit të pronësisë përcaktohen në aneksin A, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Elementet e sigurisë së certifikatës së vërtetimit të pronësisë përcaktohen në aneksin B, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.309, datë 25.5.2007

PËR MIRATIMIN E VLERËS SË AKSIONEVE TË BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.9314, datë 11.11.2004 “Për privatizimin e aksioneve, pronë e shtetit shqiptar, të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Miratimin e vlerës të aksioneve të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë, në shumën 740 (shtatëqind e dyzet) milionë lekë, sipas raportit të vlerësimit.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.310, datë 25.5.2007

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2007, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË. PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE PËR KURIMIN, NË SHBA, TË ZNJ. ZAMIRA SINOIMERI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të neneve 8 e 12 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, në programin “Administrim, planifikim, menaxhim”, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve për kurimin, në SHBA, të znj. Zamira Sinoimeri.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të kryhet pas paraqitjes së faturave origjinale nga institucioni, që ofron shërbimin.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 21.7.2010

Doli nga shtypi më 23.7.2010

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Mediaprint
Tiranë, 2010

Çmimi 32 lekë